



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Ministarstvo Poljoprivrede,
Sumarstva i Ruralnog Razvoja- Ministry of Agriculture, Forestry and Rural
Development*

Duke u bazuar në nenin 1.3 pika (d) të Rregullores së UMNİK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe nenin 16, të Ligjit Nr.21/2004 për Veterinarinë të datës 30.07.2004. Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Nxjerr sa vijon :

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.17/2008
Për përcaktimin e cilësisë së vezëve

Neni 1
Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik përcaktohen kushtet të cilat ndikojnë në cilësinë e vezëve të cilat dalin në treg e që kanë të bëjnë me emërtimin, kushtet e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë vezët, grumbullimin e vezëve në qendrat paketuese, klasifikimin, etiketimin, riklasifikimin, evidentimin e prodhimit dhe paketimit të vezëve si dhe kontrollin e cilësisë së tyre.

Neni 2

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ nuk zbatohen për vezët të cilat janë:

- a) fituar-mbledhur nga pulat vojse-vijat prindore për reproduktion,
- b) transportohen menjëherë prej vendit të prodhimit deri tek qendra e paketimit,
- c) të destinuara për industri,
- d) në vendin e prodhimit i shiten konsumatorit për nevojat e tij personale,
- e) tregtohen shiten të papaketuara në treg në vendin e prodhimit, direkt nga prodhuesi i cili ka në prodhim më së shumti deri në 350 pula,
- 6) importohen dhe eksportohen në sasi e cila nuk e tejkalon numrin prej 60 kokrra vezë e që janë të destinuara për nevoja personale të konsumatorit.

Neni 3
Përkufizimet

Për kuptimin e këtij udhëzimi administrativ, termet e përdorur në të kanë këtë domethënie:

“**Vezë**”- janë vezë të pulës në gëzhjojë prej pulave voise të destinuar për ushqim të njerëzve ose përdorimit në industri ushqimore;

“**Vezë industriale**”- janë vezët në gëzhjojë, duke përfshirë edhe vezët e dëmtuara dhe vezët për reproduksion që nuk janë të destinuar për konsum human ose përdorimit në industrinë. Në vezë industriale nuk hynë vezet e ziera;

“**Vezë për reproduksion**”- janë vezët e destinuar për çelje të zogjëve;

“**Vezë të thyera**” - janë vezët me gëzhjojë dhe membranë të dëmtuar, nga të cilat mund të ketë derdhje të përmbajtjes;

“**Vezë të dëmtuara**”- janë vezët me gëzhjojë të dëmtuar, por të pathyera dhe me membranë të padëmtuar,

“**Vënja në treg**”- është vënia e vezëve në qarkullim për shitje duke përfshirë edhe ofertën për shitje, shitjen ose cilen do menyre të transferit pa marrë parasysh a është me pagesë ose pa pagesë, distribuimin dhe mënyrat tjera të transferit, importin dhe eksportin e vezëve.

“**Qendra paketuuese**”- është qendra e menaxhuar nga personi juridik ose fizik i autorizuar për klasifikim të vezëve sipas cilësisë dhe peshës, paketimin e vezëve dhe mund të jetë i vendosur edhe në kuader të njësisë prodhuese;

“**Prodhuesi**”- është personi i regjistruar për prodhim të vezëve;

“**Seria**”- nënkupton vezët e të njëjtës qendër paketuuese të cilat janë të grumbulluara në një qendër paketuuese dhe të cilat janë të parapaketuara ose të pa paketuara, dhe që duhet të shenjzohen-etiketohen me afatin e njëjtë të përdorimit respektivisht datën e prodhimit, dhe të kenë shenja -etiketa të njëjta të kategorizimit në klasa sipas cilësisë dhe peshës;

“**Paketim i vogël**”- është paketimi që përmban më së shumti deri në 36 kokrra vezë, në paketime të vogël nuk hyjnë kartonet e hapur;

“**Paketimi i madh**”- nënkupton paketimin që përmban më shumë se 36 kokrra vezë;

“**Shitja e vezëve të papaketuara**”- është shitja e vezëve me pakicë respektivisht shitje direkte konsumatorit të fundit;

“**Njësia transportuese**”- është kontejneri, paketimi ose një formë tjetër e paketimit me të cilën transportohen vezët;

“**Autoriteti kompetent**”- është Agjencioni i Veterinarisë dhe i Ushqimit të Kosovës – AVUK-së;

“**Veterinar i autorizuar**” nënkupton veterinarin e autorizuar nga ana e Autoritetit kompetent.

Neni 4

4.1 Vezët të cilat dalin në treg, duhet të prodhohen, paketohen, ruhen dhe transportohen në mënyrë që të sigurohet ruajtja e cilësisë së tyre.

4.2 Vezët e pulave nuk lejohet të përzihen me vezët e llojeve tjera.

4.3 Vezët rastësisht të thyera ose të dëmtuara në qendrat e paketimit mund t'i distribuohen industrisë për përpunim.

Neni 5

Grumbullimi i vezëve dhe qendrat paketuuese

5.1 Vezët duhet të grumbullohen dhe t'i distribuohen qendrës paketuuese nga ana e prodhuesit ose të grumbullohen te prodhuesi nga ana e qendrës paketuuese çdo të (tretën) ditë ose një herë në javë nëse janë mbajtur në fermë në temperaturë më të ulët se 18° C.

5.2 Vezët që do të jenë të shenjuara - etiketuara me datën e prodhimit, si dhe ato që janë të destinuar për treg si vezë të klases “A” me shënjen “Ekstra” duhet t'i distribuohen

qendres paketuese në mënyrë direkte nga prodhuesi, ose të grumbullohen te prodhuesi nga ana e qendrës paketuese:

- a) në ditën e prodhimit së vezës nga pula çdo ditë pune;
- b) çdo të dytën ditë pune- nëse vezët mbahen në fermë në temperaturë më të ulët se 18°C.

Neni 6

6.1 Para nisjes së vezëve nga njësia prodhuese çdo dërgesë duhet të jetë e shënjuar-etiketuar me të dhënat e poshtëshënuara:

- a) emri, adresa dhe numri i njësisë prodhuese,
- b) numri i vezëve dhe pesha,
- c) data e prodhimit së vezës nga pula,
- d) data e dërgimit.

6.2 Të dhënat nga paragrafi 1 të këtij neni duhet të jenë në dërgesë dhe me dokumentacion përcjellës, të cilin qendra paketuese është e obliguar t'a ruaj së paku gjashtë muaj.

6.3 Nëse qendrës paketuese i dërgohen vezë të papaketuara prej njësisë prodhuese që ndodhet në të njëjtin lokacion, të dhënat nga paragrafi 1 të këtij neni evidentohen në qendrën paketuese.

Neni 7

Qendra paketuese

7.1 Qendra paketuese kategorizon, paketon dhe identifikon vezët dhe dërgesat e vezëve më se voni ditën e dytë prej ditës së pranimit të vezëve.

7.2 Paketimi dhe identifikimi i dërgesës së vezëve mund të kryhet brenda tri ditëve, nëse vezët janë të paketuara në një qender tjetër paketuese prej qendres paketuese e cila ka bërë klasifikimin dhe identifikimin e tyre.

7.3 Kategorizimi dhe paketimi i vezëve duhet të kryet ditën e prodhimit të vezëve ose ditën e pare të punës për vezët që do te identifikohen si me datën e prodhimit, dhe të cilat nuk janë paketuar në dërgesa dhe dërgohen nga njësia prodhuese në qendren paketuese që ndodhet në të njëjtin lokacion.

Neni 8

8.1 Kushtet të cilat duhen t'i plotësojë qendra paketuese si dhe procedurat e aprovimit janë të përshkruara me rregulla të veçanta.

8.2 Hapësira e qendrës paketuese duhet të jetë e dedikuar për përpunimin, klasifikimin, paketimin, identifikimin dhe ruajtjen e vezëve.

8.3 Qendra paketuese duhet t'i ketë këto pajisje teknike:

- a) pajisjen për ndriqimin e vezëve -ndriques të pavarur individual që e mundëson verifikimin e cilësisë së secilës vezë, pajisjen për matjen e ajrit në hapësirën e vezës;
- b) pajisjen për kategorizimin e vezëve sipas peshës;
- c) nje apo me shume peshore të atestuara për matje të vezëve;
- d) pajisjen për shenjzim- identifikim të vezëve.

8.4 Hapësirat duhet te mbahen të pastra, teknikisht në rregull, si dhe pa aromë .

Neni 9

Klasifikimi i vezëve

Duke iu referuar cilësisë së vezëve, vezët kategorizohen në:

- a) vezë të klases "A" ose vezë të freskëta;
- b) vezë të klases "B" të dedikuara për përpunim industrial.

Neni 10

10.1 Vezët e klasit "A" duhet që në momentin e paketimit t'i plotësojnë se paku këto kushte:

- a) që gëzhoja dhe nënlekura të jenë të formës normale të pastërta dhe pa dëmtime;
- b) që hapësira e ajrit të mos jetë më e lartë se 6 mm dhe të jetë e palevizshme; kurse për vezë që do të identifikohen si "extra" nuk lejohet të tejkalojë 4 mm;
- c) që të bardhët e vezës të jetë i këthjellët, i tejdukshëm dhe kompakt;
- d) që të kuqet e vezës gjate ndriqimit të shihet si hije e leqeve të paidentifikuara dhe gjatë manipulimit të shpejt me vezë të mbetet e palevizshme ose pjesërisht të levizë dhe të ndodhet në mes të vezës;
- e) që embrioni të ketë zhvillim të pavërejtur;
- f) që mos të ketë trupa të huaj;
- g) që mos të ketë aromë të huaj.

10.2 Vezët e klasit të parë nuk lejohet para dhe pas kategorizimit të lahen ose në qfarëdo mënyre të pastrohen.

10.3 Vezët që i nënshtrohen procedurave të larjes nuk lejohen të shenjzohen, identifikohen si klasa "A" edhe nëse i plotësojnë kriteret tjera për atë klasë të vezëve, dhe duhet të identifikohen si "vezë të lara pastuara".

10.4 "Vezët e klases "A" nuk lejohet t'i nënshtrohen procedurës së konservimit ose të ftohesh në temperaturë më të ulët se +5 °C.

10.5 Vezët që ruhen në temperaturë më të ulët se +5 °C me pak se 24 orë, nuk do të konsiderohen si të ftohura në rast të transportit - dërgimit në deponë e subjektit me pakicë dhe nëse sasia e vezëve nuk kalon sasinë e nevojshme për shitje tri ditore.

10.6 Vezët që i janë nënshtuar procesit të ftohjes nuk lejohet të etiketohen si vezë të klasit "A" as kur i plotësojnë kërkesat tjera për atë klasë të vezëve, dhe duhet të etiketohen me fjalet "vezë të ftohura".

Neni 11

Vezët e klasit "B" janë vezë që nuk i plotësojnë kërkesat e aplikueshme për vezë të klasit "A".

Neni 12

12.1 Vezët e klasit "A" dhe vezët e lara-pastruara me rastin e vënies në treg duke marrë parasysh peshën kategorizohen në katër klasë dhe shenjohen me:

- a) »XL« – Vezë shumë të mëdha prej 73 g e tutje;
- b) »L« – Vezë të mëdha : prej 63 g deri 73 g;
- c) »M« – Vezë mesatare: prej 53 g deri 63 g;
- d) »S« – Vezë të vogla: me peshë me te vogël se 53 g.

12.2 Në paketim pesha dhe klasa e vezëve shenohet me shkronja përkatëse, fjalë ose me kombinimin e të dyjave në përputhshmeri me paragrafin 12.1 të këtij neni

12.3 Nuk lejohet kategorizimi i mëtejshëm në klasë sipas peshës me përdorimin e ngjyrave të ndryshme, simboleve, shenjave tregtare e të ngjashme,

12.4 Nëse vezët e klasit “A” përveç atyre me shenjen ekstra me pesha të ndryshme vendosen në një paketim të përbashkët pesha e përgjithshme e vezëve duhet të shënohet me gram dhe me fjalet “Vezë me pesha të ndryshme”

12.5 Kur vezët e klasit “A” dërgohen në industri për përpunim me atë emërtim, shenja për peshën nuk është e obligueshme në paketim.

Neni 13

Kushtet e përgjithshme për identifikim të vezëve

13.1 Shenjat e shtypura në vezë dhe të vendosura në paketim duhet të shihen qartë dhe të jenë të lexueshme.

13.2 Ngjyra që përdoret për shenjzimin, identifikimin e vezëve duhet t'i plotësojë kushtet e udhëzimit të veçant administrativ me të cilin përcaktohet përdorimi i ngjyrave në ushqim për konsum human.

Neni 14

14.1 Vezët e klases “A” dhe vezët e lara duhet të identifikohen me shenjat si në vijim:

- a) madhesia më e vogël e diametrit të rrethit 12 mm i cili ndodhet rreth shenjes së klasës sipas peshës në përputhshmëri me nenin 12 të këtij udhëzimi administrativ të shkruar me shkronja të cilat janë më së paku 2mm të larta;
- b) vendi i origjinës (për Republikën e Kosovës: KS);
- c) numri i prodhuesit, i lartësisë së paku 2 mm;
- d) numri i qendrës së autorizuar i lartësisë së paku 2 mm;
- e) shënime mbi mënyrën e kultivimit të pulave të shënuara me numra në përputhshmëri me dispozitat e nenit 22 të këtij udhëzimi administrativ.

14.2 Nëse qendra paketuese është njëherit edhe prodhues i vezëve, në vezë vendoset shenja e prodhuesit.

Neni 15

15.1 Vezët e klases “A” mund të identifikohen me një ose me më shumë shenja si:

- a) data e paketimit, ose nëse vezët shiten si të papaketuara, data e kategorizimit;
- b) klasa e vezëve;
- c) emri tregtar dhe shenjat;
- d) data lëshimit të vezëve;
- e) mënyra e të ushqyerit të pulave vojse;
- f) shënime të tjera të cilat konsumatorit i ofrojnë informata shtesë.

15.2 Vezët e klases “A” të cilat i humbasin vetitë cilësore të asaj klase nuk lejohet që të deklarohen si të tilla por kategorizohen në klasën “B”.

15.3 Vezët e klasit “A” të cilat i humbasin vetitë cilësore mund të dërgohen direkt në industri për përpunim.

Neni 16

16.1 Vezët e klasës "B" përveç vezëve të dëmtuara duhet të identifikohen me shenjen e klasës. Në to mund të vendosen edhe shenjat tjera nga paragrafi 15.1 i këtij udhëzimi administrativ.

16.2 Shenja për vezë të klasës "B" është rrethi me diametër më të vogël të mundshëm prej 12mm që ndodhet rreth shkronjës "B" që është me lartësinë më të vogël të mundshme prej 5mm.

16.3 Nëse vezët dërgohen direkt në përpunim industrial në paketim duhet të shenohet qartë, atëherë shenja nuk duhet të vendoset në çdo kokërr të vezës.

Neni 17

Dispozita të përgjithshme për paketimin e vezëve

17.1 Paketimet e mëdha dhe të vogla të vezëve edhe kur janë në kuader të paketimeve të mëdha duhet që në anën e jashtme të paketimit të kenë të dhënat në vijim:

- a) emrin, adresën dhe shenjen tregtare të subjektit i cili i ka paketuar vezët ose i ka dërguar në paketim;
- b) numrin e qendrës së autorizuar për paketim ose i prodhuesit;
- c) klasën dhe peshën, vezët e klasës "A" shenohen me shkronjen "A" bashkërisht me fjalën: "e freskët";
- d) numrin e vezëve në paketim;
- e) shenimet mbi afatin minimal të skadimit në përputhshmëri me dispozitat e nenit 18 të këtij udhëzimi administrativ.

17.2 Paketimet e mëdha dhe të vogla të vezëve mund të kenë në anën e jashtme dhe të mbrendshme të paketimit të dhënat në vijim:

- a) çmimin e shitjes;
- b) kushtet specifike të deponimit;
- c) datën e paketimit;
- d) datën e rekomanduar të shitjes;
- e) datën e prodhimit të vezëve;
- f) shënime mbi mënyrën e të ushqyerit të pulave vojse;
- g) shenjen e origjinës së vezëve;
- h) numrin e shitjes me pakicë ose numrin kontrollues të depos;
- i) mbishkrime për rritje të shitjes, por pa e vënë në dyshim blerësin;
- j) shënime të tjera të cilat do t'i mundesojnë blerësit informata shtesë.

Neni 18

Shenja e afatit minimal të përdorimit

18.1 Afati minimal i përdorimit duhet të shënohet në paketim të vezëve, dhe shënohet në përputhshmëri me dispozitat specifike të legjislacionit për deklarimin dhe identifikimin e përgjithshëm të ushqimit.

18.2 Në përputhshmëri me paragrafin 1 të këtij neni, afati minimal i skadimit shënohet me fjalët: "të përdoren deri." (data).

18.3 Data duhet të shënohet në këtë mënyrë:

- a) dita, të shënohet me numra prej 01-31;
- b) muaji, të shënohet me numra 01-12.

18.4 Data minimale e skadencës për vezë të klasës "A" dhe vezë të "lara" është ajo datë deri në të cilën vezët i ruajnë vetitë në përputhshmëri me nenin 10 të këtij udhëzimi

administrativ kur janë të ruajtura sipas rregullave. Data minimale e afatit të skadimit nuk lejohet të jetë më i gjatë se 28 ditë prej ditës së prodhimit.

18.5 Paketimet e mëdha dhe të vogla, edhe kur janë në kuader të paketimeve të mëdha, duhet në anën e jashtme të kenë deklaratën e lexueshme që vezët duhet të ruhen- mbahen në vend të ftohet pas blerjes.

Neni 19

Shenja e datës së paketimit

Shenja e datës së paketimit mund të vendoset në paketim të vezëve të destinuara për shitje dhe përbëhet prej fjalëve: “data e paketimit” pas së ciles ndodhet data në përputhshmëri me dispozitat e nenit 18.3 të këtij udhezimi administrativ.

Neni 20

Data e rekomanduar e shitjes

20.1 Pranë datës së afatit minimal të skadimit mundet në momentin e paketimit, në vezë ose në paketim të vendoset data e rekomanduar e paketimit e cila përbëhet prej fjalëve“ të përdoret deri”, pas së cilës ndodhet data në përputhshmëri me dispozitat e nenit 18.3 të këtij udhezimi administrativ.

20.2 Data e rekomanduar e shitjes së vezës konsumatorit nuk lejohet të jetë më e gjatë se 21 ditë prej ditës së prodhimit.

Neni 21

Shenja e datës së prodhimit të vesë

21.1 Shënimet për datën e prodhimit të vesë, munden në momentin e paketimit të vendosen në paketim, dhe atëherë data e prodhimit duhet të jetë në të gjitha vezët që ndodhen në paketim.

21.2 Kur vezët t'i dërgohen qendres paketuese në konteiner, të gjitha vezët e të njëjtit konteiner të cilat do të identifkohen me datën e prodhimit duhet të klasifikohen dhe paktohen pa e ndërprerë procesin. Data e prodhimit të vezëve vendoset gjate klasifikimit ose menjherë pas tij.

21.3 Kur vezët nuk i dërgohen qendres paketuese në konteiner dhe nuk janë prej njesisë prodhuese e cila ndodhet në të njëjtin lokacion me qendren paketuese duhet të:

a) identifkohen me datën e prodhimi, respektivisht ditën e parë të punës nëse janë prodhuar gjatë ditëve të cilat nuk kanë qenë ditë pune së bashku me vezët që janë lëshuar-prodhuar atë ditë;

b) klasifikohen dhe paktohen në përputhshmëri me paragrafin 2 të këtij neni,i dërgohen qendrave tjera paketuese ose industrisë ushqimore në ditën e prodhimit ose ne ditën e parë të punës nëse janë prodhuar gjate ditëve në të cilat nuk kanë qenë ditë pune.

21.4 Deponimi dhe përpunimi i vezëve të prodhuesve tjerë, të cilat dërgohen në qendrat paketuese, dhe nuk parashihet që të identifkohen me ditën e prodhimit duhet të bëhet ndaras.

Neni 22

Shenja e mënyrës së kultivimit të pulave

22.1 Shënimet mbi kultivimin e pulave duhet të ndodhen në vezë dhe mund të ndodhet edhe në paketim të vezëve.

22.2 Shënimet mbi mënyrën e kultivimit të pulave që ndodhen në paketim të vezëve përbëhen prej fjalëve dhe numrave:

- a) »0 –vezë të mbarështimit ekologjik«;
- b) »1 –vezë të mbarështimit lirë«;
- c) »2 – vezë të mbarështimit në dysheme«;
- d) »3 – vezë të mbarështimit në kafaz- bateri «.

22.3 Shënimet në vezë mbi mënyrën e mbarështimit të pulave, varësisht prej mënyrës së si shënohen me numra.

- a) »0« për vezë të mbarështimit ekologjik;
- b) »1« vezë prej mbarështimit të lirë;
- c) »2« vezë prej mbarështimit në dysheme;
- d) »3« vezë prej mbarështimit në kafaz -bateri.

22.4 Kushtet që duhet plotësuar për t'u përcaktuar mënyra e mbarështimit janë të përcaktuara me dispozita të veçanta.

Neni 23

Shenjat për mënyrën e të ushqyerit

23.1 Vezët e klases “A” dhe “vezët e lara” respektivisht paketimet e tyre mund të kenë shenjën mbi mënyrën e të ushqyerit të pulave vojse nëse:

- a) drithërat si përbërës të ushqimit janë të përfshirë në më së paku në 60% të sasisë së përgjithshme dhe nuk përmbajnë më shumë se 15% nën-produkte;
- b) nëse ndonjë drith përbënë së paku 30% të sasisë së përgjithshme, respektivisht nëse ushqimi përbëhet prej më shumë llojeve të drithërave, atëherë secili drith duhet që të përfaqësohet se paku me 5% në sasinë e përgjithshme.

23.2 Paketimet e mëdha dhe te vogla të identifikuar me mënyrën e kultivimit, duhet të kenë mbishkrime të njëjta.

23.3 Kur vezët të shiten të papaketuara, shënimet për mënyrën e kultivimit të pulave vojse mund të përdoren vetëm atëherë kur çdo vezë është e shënuar me pergjegjësi sipas rregullave.

Neni 24

Shënime për origjinën e vezëve

24.1 Paketimet me vezë të klases “A” dhe “vezë të lara” mund të kenë edhe shenjën e origjinës së vezëve, respektivisht të kenë mbishkrimin: “prejardhja e vezëve - të shikohet shenja në vezë.”

24.2 Paketimet e mëdha dhe të vogëla të vezëve që kanë shenjën e origjinës, duhet të kenë mbishkrime të njëjta.

24.3 Te vezët e papaketuara, shenja e origjinës mund të përdoret vetëm nëse çdo kokërr vezë është e shënuar në përputhshmëri me paragrafin 1 të të këtij neni.

Neni 25

Identifikimi i vezëve të importuara

25.1 Vezët gjatë importit dhe vënies në treg duhet t'i plotësojnë dispozitat e këtij udhëzimi administrativ.

25.2 Vezët gjatë importit duhet të jenë në paketime të mëdha dhe paketime të vogla dhe të kenë mbishkrim të lexueshem me të dhënat në vijim:

- a) vendi i origjinës;
- b) emri importuesit;
- c) emri i distributorit;
- d) emri i prodhuesit respektivisht i qendres paketuese;

- e) shenja e klases sipas cilësisë dhe peshës;
- f) për paketime të mëdha peshën në kilogram të vezëve të paketuara dhe numrin e tyre kurse për paketimet e vogla numrin e vezëve;
- g) data e paketimit;
- h) emri dhe adresa e dërguesit nëse behet fjalë për paketime të mëdha.

Neni 26 **Kualitei i paketimit**

26.1 Paketimet e mëdha, duke përfshirë edhe ambalazhën e brendshme duhet të jenë rezistente në goditje, e thatë, në gjendje të mirë, dhe të punuar prej materialit që i ruan vezët nga aromat e pakëndshme dhe humbja e cilësisë.

26.2 Paketimet e mëdha për transport dhe dërgim të vezëve duke përfshirë edhe ambalazhën e brendshme, mund të ri-përdorohen në qendrat paketuuese që ndodhen jashtë objektit për prodhim të vezëve, nëse i plotësojnë kushtet nga paragrafi 1 e këtij neni.

26.3 Në paketimet e mëdha që ri-përdorohen nuk lejohet të shihet shenja e vjetër që mund të sjell dyshime tek konsumatori.

26.4 Paketimet e vogla nuk lejohet të ri-përdoren.

Neni 27 **Pesha minimale neto e vezëve në paketimet e mëdha**

Paketimet e mëdha të klases “A” dhe “vezëve të lara” duhet të sistemohen sipas peshës minimale të poshtëshenuar:

- a) XL – shumë të mëdha: 7.3 kg/100 vezë;
- b) L – të mëdha: 6,4 kg/100 vezë;
- c) M – mesme: 5,4 kg/100 vezë;
- d) S – të vogla: 4,5 kg/100 vezë.

Neni 28 **Identifikimi me traka, ri-klasifikimi dhe paketimi i vezëve**

28.1 Paketimet e mëdha duhet të sigurohen me trakë ose etiketë në të cilën ndodhen të dhënat nga neni 17 i këtij udhëzimi administrativ dhe pas hapjes së parë të paketimit nuk lejohet të përdoret përsëri.

28.2 Trakat dhe etiketat nuk janë të nevojshme kur paketimet e mëdha janë në formë të kutisë së hapur ose konteinerit në të cilat ndodhen paketimet e vogla me të dhënat nga neni 17 i këtij udhëzimi administrativ

28.3 Nëse vezët dërgohen çdo ditë prej qendres paketuuese në shitje me pakicë në sasi më të vogël se 3600 kokrra për një dërgesë ose 360 kokrra për një blerës, nuk kanë nevojë të paketohen në paketime të mëdha dhe të identifikohen me trakë ose etiketë, por ato dërgesa duhet të kenë dokumentacionin përcjellës.

28.4 Në dokumentacionin përcjellës duhet të shënohen të dhënat në vijim; emri, adresa dhe numri i qendres së autorizuar paketuuese, numri i vezëve, shenja e klases dhe pesha, afati minimal i përdorimit dhe mënyra e kultivimit të pulave.

Neni 29

Trakat dhe etiketat për paketimet e klases “A” dhe “vezëve të lara”, duhet të jenë me ngjyrë të bardhë, kurse shenjat me të dhënat, të shtypura me ngjyrë të zezë.

Neni 30

Trakat dhe etiketat për vezë që i destinohen industrisë së ushqimit

- 30.1 Trakat dhe etiketat duhet të jenë me ngjyrë të verdhë nëse janë të paketuara vezët:
- te destinuara për përpunim në industri ushqimore
 - kanë qenë te klasit “A” dhe kanë përfunduar t’i plotesojnë vetitë e kësaj klase dhe nuk janë kategorizuar përsëri,
 - »B« klases.
- 30.2 Në trakat dhe etiketat nga paragrafi 1 të këtij neni duhet të jenë të lexueshme me shkronja të zeza të dhënat në vijim:
- emri dhe adresa e subjektit që distributon vezë;
 - numri dhe pesha në netto e vezëve;
 - shenjen “Vezë për industri ushqimore” të shkruar me shkronja të zeza të larta 2 cm.
- 30.3 Traka ose etiketa nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni mund të përdoret vetëm njëherë.

Neni 31

Traka dhe etiketa për vezë industriale

- 31.1 Nëse vezët e paketuara i janë destinuar përpunimit industrial, trakat dhe etiketat duhet të jenë me ngjyrë të kuqe
- 31.2 Në trakat dhe etiketat nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jenë të vendosura të dhënat e lexueshme:
- emri dhe adresa e subjektit për të cilin janë destinuar vezët;
 - emri dhe adresa e subjektit që i distribuon vezët;
 - shenja “Vezë industriale” e shkruar me shkronja të zeza të shtypit të larta 2 cm dhe shenja “të papërshtatshme për ushqim të njerëzve” e shënuar me shkronja të zeza të larta 0.8 cm.
- 31.3 Traka dhe etiketa nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të përdoret vetëm një herë.

Neni 32

Vezët me shenjen “ekstra”

- 32.1 Fjala “ekstra” mund të përdoret në paketimet e vogla të vezëve të klases “A” dhe duhet të jetë në trakë ose etiketë që është e shtypur në atë mënyrë që çdo e dhënë në paketim të jetë e lexueshme.
- 32.2 Fjala “ekstra” duhet të jetë e shtypur në trakë ose etiketë me shkronja italiane të larta së paku 1 cm. Pas fjalës “ekstra” vijon fjala “deri” dhe shenja e datës në përputhshmëri me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 18 të këtij udhëzimi administrativ, që kanë të bëjnë me ditën e shtatë pas paketimit të vezëve dhe ditën e nëntë pas prodhimit të vezëve.
- 32.3 Nëse në paketim është e shënuar data e paketimit të vezëve, fjala “ekstra” mund të zëvendësohet me fjalët »ekstra deri në ditën e shtatë pas paketimit“.
- 32.4 Nëse në paketim është e shënuar data e prodhimit të vezëve fjala “ekstra” mund të zëvendësohet me fjalën »ekstra deri në ditën e nëntë pas prodhimit“.
- 32.5 Pas fjalës “ekstra” mund të shtohet fjala “e freskët”.
- 32.6 Nëse traka ose etiketa nuk është e mundur të largohet nga paketimi, vezët duhet të largohen prej shitjes më së voni ditën e shtatë pas paketimit të vezëve ose ditën e nëntë pas prodhimit të vezëve, dhe ato vezë duhet të ripakëtohen.

32.7 Paketimet e mëdha të cilat përmbajnë disa paketime të vogla duhet të shënohen me shkronja të shtypit me lartësi 2 cm me mbishkrim "PAKETIMI PËRMBAN PAKETIME TË VOGLA EKSTRA «.

Neni 33 **Ripaketimi i vezëve**

33.1 Vezët e klases "A" dhe vezët e "lara" munden të paketohen përsëri në paketime të mëdha ose të vogla vetëm në qendrat paketuuese.

33.2 Ripaketimet duhet të përmbajnë vetëm vezë të të njejtës seri.

33.3 Traka ose etiketa në paketimet e mëdha të vezëve duhet të kenë të dhënat në vijim:

- a) emri dhe adresa e subjektit që ri-paketon vezët ose i ka ri-paketuar;
- b) numri i qendrës së autorizuar paketuuese që i ka ripaketuar vezët;
- c) klasa e vezëve dhe pesha;
- d) numri i vezëve të paketuara;
- e) datën dhe afatin minimal të përdorimit dhe nën të fjalët: "vezë të ripaketuara";
- f) mënyrën e kultivimit të pulave;
- g) vërejtjet mbi ruajtjen e vezëve;
- h) numri i qendrës së autorizuar paketuuese që i pari ka paketuar vezët ose vendin e origjinës për vezë nga eksporti.

33.4 Paketimet e vogla në të cilat janë ripaketuar vezët, duhet të kenë të dhënat nga paragrafi i mësipërm, të cilat duhet të jenë të lexueshme, dhe mund të kenë shenjen tregtare të subjektit që i ka ripaketuar vezët. Fjala "ekstra" nuk lejohet të përdoret.

Neni 34 **Riklasifikimi i vezëve**

34.1 Vezët që kanë kaluar në procedurat e riklasifikimit mund të vehen në qarkullim për shitje në paketimet e njëjta në të cilat kanë qenë para riklasifikimit. Nëse ato vezë janë ripaketuar, çdo paketim mund të përmbajë vetëm vezë të serisë së njëjtë.

34.2 Traka e verdhë ose e kuqe në paketimet e mëdha në të cilën ndodhen vezët që janë riklasifikuar duhet të jenë shënuar me ngjyrë të zezë të dhënat nga neni 30 dhe 31 i këtij udhëzimi administrativ.

34.3 Paketimet e vogla në të cilat ndodhen vezët që janë ripaketuar, duhet të përmbajnë të dhënat nga paragrafi 34.2 i këtij neni, të shkruara me shkronja të lexueshme.

34.4 Nëse përsëri përdoren paketimet origjinale, të dhënat që nuk vlejné duhet të mbulohen. Paketimet e vogla duhet të jenë të identifikuar me shenjen tregtare të subjektit që i ka riklasifikuar vezët ose me të dhënat e subjektit që i ka dërguar në riklasifikim.

Neni 35 **Evidencimet e prodhimit dhe të paketimit të vezëve**

35.1 Prodhuesit e vezëve duhet të mbajnë evidencë për mënyrën e kultivimit dhe të ushqyerit të pulave vojse, në raste kur vezët e klases "A" dhe paketimet e tyre mbajnë atë shenjë.

35.2 Shënime mbi kultivimin e pulave duhet të përmbajnë këto të dhëna:

- a) data e hyrjes së pulave në objekt, moshën dhe numrin e pulave;
- b) largimi i pulave vojse nga rritja dhe prodhimi i mëtutjeshëm;
- c) prodhimi ditor i vezëve;
- d) numri ditor i vezëve të shitura me emrin dhe adresën e subjektit që ka pranuar vezët.

35.3 Shënimet mbi të ushqyerit e pulave vojse në rastet kur vezët e klases “A” dhe paketimet e tyre që e mbajnë shenjen e kësaj klase duhet të kenë të dhënat në vijim:

- a) sasia dhe lloji i ushqimit të pranuar nga furnizuesi ose të përgatitur në farmë;
- b) data e pranimit të ushqimit;
- c) emri i prodhuesit ose i furnizuesit;
- d) numri dhe mosha e pulave vojse dhe numri i vezëve të prodhuara dhe distribuara;
- e) data e dërgimit të vezëve;
- f) emri dhe adresa e blerësit dhe qendres paketuese.

35.4 Shënimet mbi datën e prodhimit duhet të shënohen ndaras në raport me të dhenat tjera nga ky nen.

35.5 Prodhuesi duhet t’i ruaj shënimet nga ky nen më së paku 6 muaj pas ndërprejes së aktivitetit, respektivisht pasi që tufa të përfundojë ciklin e prodhimit.

Neni 36

Shënimet e Qendres Paketuese

36.1 Qendrat paketuese duhet të mbajnë shënime të posaçme ditore për mënyrën e rritjes, të cilat duhet të përmbajnë këto të dhëna:

- a) sasia e vezëve që pranohet në qendrën paketuese, numri i vezëve të dëmtuara që janë pranuar, emri dhe selia e personit fizik ose juridik që kanë sjell vezët, numri i prodhuesit të autorizuar dhe data ose periudha e lëshimit të vezëve;
- b) sasia e vezëve që nuk janë kategorizuar dhe i janë distribuar qendrave tjera paketuese, numrin e autorizimit të atyre qendrave paketuese dhe datën ose periudhën e prodhimit të vezëve;
- c) kategorizimi dhe klasifikimi sipas peshës;
- d) sasia e vezëve të kategorizuara të pranuar nga qendrat tjera paketuese, numrat e autorizimit të këtyre qendrave paketuese, afatin minimal të përdorimit dhe shënimet mbi identitetin e shitësit;
- e) numri dhe pesha e vezëve të dërguara, klasifikimi sipas peshës, data e paketimit dhe data e përdorimit, emri dhe adresa e blerësit.

36.2 Qendrat paketuese duhet t’i plotësojnë të dhënat çdo javë.

36.3 Nëse vezët e klases “A” dhe ”vezët e lara” kanë shenjen mbi mënyrën e të ushqyerit të pulave vojse, datën e prodhimit të vezëve, qendrat paketuese duke i shfrytëzuar këto të dhëna duhet të kenë shënime të veçanta në përputhshmëri me paragrafin 1 të këtij neni.

36.4 Në vend të evidencës së shitjes dhe dërgesave qendrat paketuese mund të posedojnë faturat e shitjes në përputhshmëri me paragrafin 36.1 të këtij neni të cilat duhet të ruhen së paku 6 muaj.

Neni 37

Evidencimet e subjektëve tjerë

37.1 Për vezët sipas neneve 22, 23 dhe 24 të këtij udhezimi administrativ, tregtarët e vezëve me shumicë duhet të mbajnë shënime të pranimit, shitjes dhe stokeve të vezëve së paku 6 muaj.

37.2 Tregtarët me shumicë të vezëve duhet të mbajnë shënime me të dhënat si në vijim:

- a) data dhe sasia e vezëve të pranuar dhe të shitura;
- b) emrat dhe adresat e furnizuesve dhe shitësve me pakicë.

37.3 Tregtarët e vezëve me shumicë obligohen të mbajnë shënime javore për stoqet-sasinë e vezëve në depo.

37.4 Në vend të mbajtjes së shënimeve të posaçme mbi pranimin dhe shitjen, tregtarët me shumicë mund të posedojnë faturat e shitjes ose fletëdergesat në përputhshmëri me nenin 22,23.dhe 24 të këtij udhëzimi administrativ.

37.5 Prodhuesit e ushqimit për pula dhe furnitoret duhet të mbajnë shënime për dërgesat e tyre prodhuese të vezëve në përputhshmëri me nenin 35, paragrafi 3 i këtij udhëzimi administrativ.

37.6 Prodhuesit e ushqimit për pula duhet t'i ruajnë të dhënat nga paragrafi 5 i këtij neni së paku gjashtë muaj.

Neni 38 **Kontrolla e cilësisë të vezëve** **Mostrimet**

38.1 Kontrolla e vezëve në paketime të mëdha, të cilat nuk përmbajnë paketime të vogëla, zbatohet me marrjen e mostrave të vezëve, numëri më i vogël i cili merret, dhe është përcaktuar në tabelën 1 e cila është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ.

38.2 Kontrolla e vezëve në paketime të vogla, pa marrë parasysh a janë paketimet e vogla në kuadër të paketimeve të mëdha, aplikohet me marrjen e mostrave të paketimeve dhe vezëve numerit më i vogël i të cilave është në tabelën 2 e cila është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ.

38.3 Kontrollimi i serisë së prodhimit që është më e vogël se 18.000 vezë, mostrimi aplikohet në më se paku 20% të paketimeve të mëdha.

38.4 Kontrollimi i serisë që është më e madhe se 18.000 vezë aplikohet në më se paku 10% të mostrave dhe së paku dhjetë paketime të mëdha.

38.5 Në raste të vezëve të papaketuara që vehen në qarkullim për shitje, kontrolla bëhet në mostrat:

a) 100% , kur numri i vezëve është 180;

b) 15% por jo më pak se 180 vezë kur numri i vezëve është më i madh se 180.

38.6 Kontrollin e bënë inspekcioni i autorizuar nga Autoriteti kompetent.

Neni 39 **Trakat Kontrolluese**

39.1 Pas kontrollës së serisë të vezëve inspektorët e autorizuar, me kërkesë të pronarit në paketim mund të vendosin trakën e kontrollit me vulën zyrtare dhe të dhënat në vijim:

a) “Kontrolluar data dhe vendi”;

b) emri dhe numri identifikues i inspektorit.

39.2 Traka kontrolluese nga paragrafi 1 e këtij neni duhet të jetë me ngjyrë të bardhë dhe shkronja me ngjyrë të kuqe. Nëse para kontrolles zyrtare paketimi ka qenë i mbyllur, inspektori mund t'a hapë paketimin dhe në të të vendos traken kontrolluese. Traka kontrolluese mund të vendoset mbi traken ose etiketën origjinale.

39.3 Pas kontrollit duhet të përmbajë shënimet nga paragrafi 1 i këtij neni dhe fjalën ekstra të shënuar me shkronja italiane të lartësisë 1 cm.

Neni 40 **Devijimet e lejuara në cilësi**

40.1 Për vezët e serisë së klases “A” dhe “vezët e lara” nga rregullat e përcaktuara janë të lejuara devijimet si në vijim:

a) në qendrën paketuuese gjatë dërgesës mund të jenë më së shumti 5% vezë me devijime në cilësi,

b) në qarkullim mund të jenë më së shumti 7% të vezëve me devijime në cilësi.
40.2 Gjate kontrollit të vezëve me shenjen “ekstra” nuk lejohen devijime në lartësinë e hapësirës së ajrit as në momentin e paketimit as në momentin e importit.
40.3 Nëse seria e kontrolluar e vezëve përmban më pak se 180 vezë, perqindjet nga paragrafi 1 i këtij neni dyfishohen.

Neni 41

41.1 Gjate kontrollit të serisë së vezëve të klases “A dhe ”vezëve të lara” devijimet e lejuara kanë të bëjnë me peshën e vezës respektivisht në serinë e vezëve mund të ketë deri në 10% vezë të klases sipas peshës që i afrohet klases së identifikuar në paketim, por jo më shumë se 5 % të klasës tjetër më të ulët sipas peshës.
41.2 Nëse seria e kontrolluar e vezëve përmban më pak se 180 kokrra vezë, perqindjet nga paragrafi 1 i këtij neni dyfishohen.

Neni 42

Për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ, kryeshefi ekzekutiv i autoritetit kompetent mund të nxjerr vendime me të cilat rregullohen çështjet e përcaktuara me këtë udhëzim administrativ.

Neni 43

43.1 Moszbatimi i këtij udhëzimi administrativ do të sanksionohet sipas nenit 45 të Ligjit për Veterinarinë dhe legjislacionit në fuqi.
43.2 Pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ është Tabela 1 dhe 2.

Neni 43 **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë 28.03.2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
Ministri,
Idriz Vehapi

Tabela 1.

Numri i vezëve ne seri	Numri i vezëve per kontroll	
	Numri i vezëve te kontrolluar% per seri	Numri minimal i vezëve
deri 180	100	-
181 deri 1 800	15	180
1 801 deri 3 600	10	270
3 601 deri 10 800	5	360
10 801 deri 18 000	4	540
18 001 deri 36 000	3	720
36 001 deri 360 000	1,5	1 080
Me shume 360 000	0,5	5 400

Tabela 2.

Numri i vezëve ne seri	Numri i vezëve per kontroll	
	Numri i vezëve te kontrolluara per paketime te vogela%	Numri i vezëve te kontrolluar per paketim %
deri 180	100	100
181 deri 1 800	15	100
1 801 deri 3 600	10	100
3 601 deri 10 800	5	100
10 801 deri 18 000	4	100
18 001 deri 36 000	3	100
36 001 deri 360 000	1,5	100
Me shume se 360 000	0,5	100

